



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Lënda: Përgjigje në lidhje me kërkesën për përcaktim të pagës referuese për efekt të pensionit suplementar

Në përgjigje të kërkesës suaj, përcjellë nëpërmjet postës elektronike, përmes së cilës kërkonti përcaktimin e pagesës referuese për pensionin suplementar për periudhën 1991-1992, gjatë së cilës keni punuar si krye Informaticiene, në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Shtetit, ju bëjmë me dije sa vijon:

Në Departamentin e Administratës Publike, për rastin tuaj, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, janë paraqitur dy kërkesa (kërkesa e parë në shtator 2021 dhe kërkesa e dytë në nëntor 2023), për përcaktimin e pagës referuese, për periudhën që keni qenë e punësuar në ish Bankën e Shtetit Shqiptar. DAP i ka kthyer përgjigje Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në të dyja rastet, e për më tepër në vitin 2021, i është drejtuar si Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore për rastin tuaj, ashtu edhe për raste të tjera të ngjashme për periudhën e punësimit në ish Bankën e Shtetit Shqiptar.

Departamenti i Administratës Publike, siç edhe jeni në dijeni dhe e citoni në kërkesën tuaj, bën përcaktimin e pagës referuese për efekt pensioni suplementar, në bazë të pikës 10, të vendimit nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kritereve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, për të gjitha ato raste kur në momentin e lindjes të së drejtës për përfitime suplementare, në aktet ligjore apo nënligjore përkatëse nuk ekziston institucioni dhe mungon funksioni/pozicioni/detyra si edhe paga për atë funksion/pozicion/detyrë.

Pra, kompetencën për përcaktimin e pagës referuese, Departamenti i Administratës Publike e ushtron vetëm në rastet:

- i) kur personit/ave u ka lindur e drejta për përfitime suplementare, (duke marrë parasysh edhe njehsimin e institucioneve për efekt page në bazë të përcaktimeve të pikës 11, të këtij vendimi) si edhe;
- ii) kur në aktet ligjore apo nënligjore përkatëse nuk ekziston institucioni dhe mungon funksioni/pozicioni/detyra si edhe paga për atë funksion/pozicion/detyrë.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Referuar kërkesës suaj, për periudhën e punësimit 01.02.1991 – 30.09.1992, gjatë së cilës, keni ushtruar detyrën në pozicionin “K/informaticiene”, në ish “Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Shtetit Tiranë”, sjellim në vëmendjen tuaj se:

i) Në ligjin nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” i ndryshuar, “Banka e Shtetit Shqiptar” nuk është i përcaktuar si një ndër subjektet përfituese nga skema e sigurimeve suplementare;

ii) Në lidhjen nr. 1, të vendimit nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar, (në pjesën e parë dhe të dytë të kësaj lidhjeje) institucionet e përcaktuara janë si vijon:

Në “Institucione kushtetuese e të pavarura” përfshihen:

Presidenca, Kuvendi i Shqipërisë, Kryeministria, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministrinë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Avokati i Popullit.

Në “Institucione të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, përfshihen:

Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ILDKP-ja dhe Konflikti i Interesave, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Institucioni “Banka e Shtetit Shqiptar”, siç është evidente, nuk është i përfshirë si një ndër subjektet përfituese në këtë lidhje.

iii) Në lidhjen nr. 3, të vendimit nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar, nuk ka asnjë emërtesë të pozicioneve nga “Titullar institucioni” deri në “Specialist” për institucionin e “Bankës së Shtetit Shqiptar”.

Departamenti i Administratës Publike i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për një interpretim më të zgjeruar, për të përcaktuar nëse ish punonjësit e institucionit “Banka e Shtetit Shqiptar” janë subjekte të përfitimit nga skema e pensioneve suplementare, por nuk kemi ndonjë përgjigje nga ana e asaj ministrie.

Për rrjedhojë, meqenëse deri aktualisht nuk kemi ndonjë përgjigje apo interpretim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku të përcaktohet apo sqarohet në se punonjësit e ish Bankës së Shtetit Shqiptar, janë subjekte përfitimi nga skema e sigurimeve suplementare, Departamenti i Administratës Publike nuk e ushtron dot kompetencën për përcaktimin e pagës referuese, si për rastin tuaj ashtu edhe për raste të tjera të ngjashme të ish kolegëve tuaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,